



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA-THE MUNICIPALITY OF
SUHAREKA



DREJTORIA PËR EKONOMI, BUXHET DHE FINANCA

NR.04/104-66612

DT.16.10.2018

N J O F T I M
PËR OBLIGUESIT TATIMOR ME
RISIT E LIGJIT NR.06/L-005 PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME

REPUBLIKA KOSOVA - KOMUNA E SUHAREKËS		REPUBLIKA KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA
NR. NO. 104-66612 2018		
MARRE NE DOREZIM / PRINTED ON 16.10.2018		
Nësia org. Org. Jedinica Org. unit	Numri Broj. Number	Ditë/2018 Date Anno/2018
ON	104	66612

Ligi për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005, vendos tatimin mbi pronën e paluajtshme dhe përcakton rregullat dhe procedurat themelore për administrimin e tatimit në pronën e paluajtshme nga Komunat dhe Ministria e Financave.

Dispozitat e këtij Ligji janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe njësitë e tyre përkatëse, përgjegjëse për zbatimin e këtij Ligji, për personat që janë të obliguar të paguajnë tatimin në pronë, si dhe për personat e tjerë të cilët janë të obliguar të zbatojnë detyrimet ligjore, sipas dispozitave të përcaktuara me këtë Ligj.

-Sipas nenit 5 të Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshm, tatimi në pronën e paluajtshme vendoset mbi të gjitha pronat e paluajtshme të cilat ndodhen në territorin e Republikës së Kosovës, me prejashtim të pronave të paluajtshme të cilat lironen nga tatimi në përputhje me nenin 10 të këtij Ligji.

-Sipas nenit 7 të këtij Ligji, baza e tatimit në pronë është vlera e tatushme e pronës së paluajtshme.
Vlera e një njësie parcele është si në vijim:

- Për vitin e parë të vendosjes së tatimit, 20% e vlerës së vlerësuar,
- Për vitin e dyte të vendosjes së tatimit, 40% e vlerës së vlerësuar,
- Për vitin e tretë të vendosjes së tatimit, 60% e vlerës së vlerësuar,
- Për vitin e katërt të vendosjes së tatimit, 80% e vlerës së vlerësuar dhe
- Për vitet tatimore në vijim, 100% e vlerës së vlerësuar.

Pas zbritjes që aplikohet sipas këtij nenit, vlera e vlerësuar e një njësie rezidenciale të parcelës mund ti nënshtronhet gjithashu zbritjes përvendbanimin parësor në zbatim të paragrafit 3 të nenit 11 të këtij Ligji.

Vlera e tatushme e qdo njësie objekti është vlera e saj e vlerësuar, pas zbritjes së mundshme në zbatim të paragrafit 1 të nenit 11 të këtij Ligji.

Për secilin vit tatimor, vlera e pronës së paluajtshme është vlera e saj e vlerësuar në 30 nëntor të vitit para vitit tatimor.

Sipas nenit 8 pika 6 të këtij Ligji, objektet e papërfunduara dhe ato të rrënuara, të cilave nuk mund t'i përcaktohet shfrytëzimi aktual dhe as ai i planifikuar, klasifikohen duke u bazuar në:

-shfrytëzimin aktual të njësisë së parcelës në të cilën është ndërtuar apo është duke u ndërtuar objekti ose
-shfrytëzimin e planifikuar të njësisë së parcelës, nëse shfrytëzimi aktual i njësisë së parcelës nuk mund të përcaktohet.

-Po qe se as shfrytëzimi i planifikuar i njësisë së parcelës në të cilën është ndërtuar apo është duke u ndërtuar objekti nuk mund të përcaktohet, komuna e klasifikon objektin si pronë rezidenciale.

-Për vitin e parë tatimor pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, klasifikimi i pronave të paluajtshme kryhet nga Ministria e Financave, ndërsa përvitet tatimore në vijim nga Komuna.

Neni 9 parashef normat tatinore të cilat i cakton komuna për të gjitha kategoritë e pronave, me prejashtim të kategorisë prone publike, deri me 30 nëntor të vitit të vendosjes së tatimit në përputhje me këtë Ligji.Kuvendi Komunal duhet t'i rishikoj normat e caktuara dhe të caktoj norma të reja tatinore,vetëm nëse një gjë të tillë e kërkojnë rrëthanat.Normat tatinore vendosen Brenda kufijve të përcaktuar si më poshtë dhe janë të vlefshme nga fillimi i vitit tatinor:

- Për njësitë bujqësore të parcelave,normat tatinore variojnë në shkallët prej 0.15% - 0.5%,
- Për njësitë bujqësore të objekteve,normat tatinore variojnë në shkallët prej 0.15% - 0.5%,
- Për njësitë pyjore të parcelave,normat tatinore variojnë në shkallët prej 0.15% - 0.3%,
- Për njësitë rezidenciale të parcelave,normat tatinore variojnë në shkallët prej 0.15% - 0.1%,
- Për njësitë rezidenciale të objekteve,normat tatinore variojnë në shkallët prej 0.15% - 0.1%,
- Për njësitë komerciale të parcelave,normat tatinore variojnë në shkallët prej 0.15% - 0.1%,
- Për njësitë komerciale të objekteve,normat tatinore variojnë në shkallët prej 0.15% - 0.1%,
- Për njësitë industriale të parcelave,normat tatinore variojnë në shkallët prej 0.15% - 0.8%,
- Për njësitë industriale të objekteve,normat tatinore variojnë në shkallët prej 0.15% - 0.8%.

Neni 11 i këtij Ligji parashet zbritjen për vendbanimin parësor, nëse personi fizik i cili vendos deri me 30 nëntor të vitit para vitit tatinor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazes së inspektimit,i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Sipas nenit 19 të këtij Ligji,Ministria e Financave lëshon qertifikatë të vlerës së vlerësuar për të gjitha pronat e paluajtshme që i nënshtronen procesit të vlerësimit në përputhje me këtë Ligji,pas qdo vlerësimi të përgjithëshem ose plotësues të pronave të paluajtshme, jo më heret se 31 dhjetori i vitit para vitit tatinor dhe jo më vonë se 15 janari i vitit tatinor.Ministria e Financave mund ta zgjas afatin e përcaktuar deri me 31 janar të të nejtit vit tatinor, duke bërë publike arësyet për zgjatjen e afatit.Brenda 5 ditëve të punës pas dates së lëshimit të qertifikatave të vlerës së vlerësuar,Ministria e Financave ua siguron ato komunave,për t'u dërguar pronar/poseduesve përkatës të pronave të paluajtshme.

Sipas nenit 23 të këtij Ligji, për vitin tatinor 2019 dhe vitet tatinore në vijim,tatimi dhe gjoba, nëse ka të këtillë,paguhen me dy këste të barabarta,deri më 30 prill dhe 30 shtator të vitit tatinor.Nëse Ministria e Financave zgjat afatin për lëshimin e faturave të tatimit, afati për të paguar kësttin e parë për atë vit tatinor zgjatet me të nejtin numër ditësh sa është zgjatur afati për lëshimin e faturave të tatimit.

Të gjithë debitoret me detyrime tatinore të pa paguara,për të cilat komuna nuk ka filluar procedurat e mbledhjes së detyrueshme sipas Ligjit nr.03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-100,mund të paguajnë të gjitha detyrimet e tyre tatinore të pa paguara deri me 30 prill 2019, nëse pagesa nuk është bërë deri më këtë date,komuna fillon zbatimin e masave të mbledhjes së detyrueshme,duke filluar me dërgimin e njofshit përfundimtar.

Sipas nenit 26 të këtij Ligji,Komuna,Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kapitulli(VII) për të mbledhur detyrimet tatinore të pa paguara që kalojnë shumën e dhjet(10) €.

Sipas nenit 29 të këtij Ligji, komuna mund të bëj pezullimin e shërbimeve komunale,nëse debitori nuk paguan detyrimet tatinore të papaguara në datën e caktuar për pagesë, në përputhje me paragrin 1 të nenit 27 të këtij Ligji,komuna Brenda 3 ditëve pune pas përfundimit të afatit për pagesë,pezullon shërbimet e caktuara komunale për atë debitor, deri në pagesen e plotë të detyrimeve tatinore të papaguara.Brenda 10 ditëve pune pas ditës së pezullimit të shërbimeve komunale,komuna njofton debitorin për pezullimin e shërbimeve komunale.Sherbimet komunale që pezullohen,përcaktohen me akt nënligjor që propozohet nga Ministria e Financave dhe miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 30 të këtij Ligji, nëse pas 180 ditëve kalendarike nga dita e fundit për pagesë,në përpunje me paragrafin 1 të nenit 27 të këtij Ligji, pagesa ende nuk është bërë,komuna merr vendim mbi ekzekutimin e detyrimeve tativore

të papaguara që kanë kaluar shumën e 300€.Vendimi merret brenda 10 ditëve të punës. Nëse komuna nuk merr vendim mbi ekzekutimin e detyrimeve tativore të papaguara brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni,vendimi merret nga Ministria e Financave,jo më vonë se 10 ditë pune pas përfundimit të atij afati.

Sipas nenit 34 të këtij Ligji parashifet rimbursimin, nëse vendimi apo aktgjykimi i marrur është në favor të tatimpaguesit ose debitorit, qdo detyrim tativor i paguar më tepër nga tatimpaguesi ose debitori dhe interesit për detyrimin të paguar më tepër,të llogaritura nga data e pagesës së detyrimit tativor deri në datën e rimbursimit,i rimbursohen tatimpaguesit ose debitorit brenda 90 ditëve kalendarike nga data kur është marrur vendimi final nga autoriteti kompetent administrativ ose gjyqësor.

Sipas nenit 35 të këtij Ligji janë paraparë gjobat, nëse poseduesi që nuk bënë kerkesë për regjistrimin e pronës së paluajtshme që ai posedon dhe nuk i siguron komunës informacionin e nevojshem në pajtim me paragrafet 3 dhe 4 të nenit 14 të këtij Ligji, i dërgohet një letër kujtesë, nëse poseduesi nuk i përbahet letër kujtesës brenda afatit prej 30 ditëve kalendarike nga data kur letër kujtesa e zyrës komunale të tatimit në pronë konsiderohet të jetë pranuar nga poseduesi,i shqiptohet gjobë në një shumë që është e barabartë me 30% të tatimit të vlerësuar në vitin pasues.

Obligohen Zyra e Informimit e komunës Suharekë, që këtë njoftim ta vendos në Web faqen e Komunës për informimin e obliguesve tativor të komunës sonë me Risit e Ligjit të Tatimit në Pronën e paluajtshme nr.06/L-005.

I Dërgohet:
-Zyrës së Informimit



D rektor i:
Agim Bylygbashi